



**Republika e Kosovës - Republic of Kosova**  
**Komuna - Municipality**  
**F E R I Z A J**



# **P L A N I I P U N Ë S**

## **NJËVJEÇARE**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

**VITI KALENDARIK 2025**

**Janar, 2025**

## Përmbajtja

Përmbajtja .....	2
Hyrje.....	3
Plani i punës .....	4
Vizioni.....	4
Misioni.....	4
Objektivat strategjike.....	5
Orientimi i përgjithshëm.....	8
Plani i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2024-2025.....	10
Koha e realizimit.....	12
Plani i punës për përgaditjen e lokaleve shkollore për vitin shkollor 2024-2025.....	12
Plani i punës së procesit edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2024-2025.....	13
Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DA-së me Kryetarin e Komunës, MASHTI-n, drejtorët e drejtorive nga komunat tjera dhe me qytetarët.....	14
Bashkëpunimi i DA-së me organet e sigurisë: Policinë, KFOR-in, OJQ dhe mediat.....	15
Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane.....	15
Buxheti i Arsimit për vitin 2025 sipas kategorive.....	16
Projektet e planifikuara për vitin Kalendarik 2025 .....	17
Plani i rekrutimit të personelit arsimor – viti kalendarik 2025.....	18

## Hyrje

Në këtë plan janë të përfshira të gjitha aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Arsimit, për katër nivelet shkollore sipas Sistemit Ndërkombëtar të Klasifikimit të Arsimit (në vazhdim SNKA) dhe atë si vijon:

- **SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII),**
- **SNKA 2 - Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasat VI-IX),**
- **SNKA 1 - Arsimi Fillor (Klasat I-V),**
- **SNKA 0 - Klasat Parafillore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje - 5 vjeç).**

Ky plan ka për bazë aktivitetet që do të realizohen në të gjitha Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe të Mesme të Larta (Gjimnaze dhe Shkolla Profesionale) në komunën e Ferizajt.

Plani i punës përfshinë aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DA-së me kryetarin e komunës, MASHTI-n, drejtoritë tjera komunale, me qytetarët, komunitetin e prindërve si dhe bashkëpunimi i DA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat, komunitetin, etj.

Plani i punës ka për bazë edhe elementet të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendeve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin permanent të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

## Plani i punës

Plani i punës është udhëzues për organizimin e punës dhe veprimin njëvjeçar të Drejtorisë së Arsimit, duke u mbështetur në faktorët shumë dimensional, e në veçanti në faktorët kryesor që paraqesin themelin e punës në Drejtorinë e Arsimit. Po ashtu plani i punës përbëhet prej disa elementeve kryesore të cilat janë të rëndësishme në ndërtimin dhe koherencën e tij, si:

### *Vizioni*

### *Misioni*

### *Qëllimi*

### *Vizioni*

Drejtoria e Arsimit synon që arsimit në Komunën e Ferizajt të zhvillohet në një ambient sa më të sigurt, modern dhe demokratik nga personeli i kualifikuar dhe i aftësuar në vazhdimësi, me përgjegjësi në punë dhe me një përfshirje cilësore të palëve të interesit. Të ofroj arsimim gjithëpërfshirës për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme të nxënësve, iniciativën ndërmarrëse dhe pavarësinë e individit në shoqëri që të përballet me sukses ndaj ndryshimeve të shpejta e të gjithmbarshme në mjedisin ku jetojmë.

### *Misioni*

Drejtoria e Arsimit do të angazhohet për të siguruar arsimim sa më cilësor, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha grupmoshat e nxënësve në mënyrë që individit të shfrytëzojë tërë aftësinë e vet në përparimin (ngritjen) e cilësisë si në mësimdhënie ashtu edhe në mësimnxënie duke zbatuar teknikat, metodat dhe strategjitë më bashkëkohore të punës në këtë sferë, duke synuar që:

- Çdo nxënësi pa asnjë dallim t'i sigurohen kushtet e nevojshme për nxënie cilësore të diturisë;
- Secili nxënës të shkollohet dhe arsimohet në mjedisin më të afërt, duke ju përshtatur nevojave të tyre sociale, fizike, kulturore dhe emocionale, duke shfrytëzuar të gjitha potencialet intelektuale, profesionale në mënyrë që nxënësve t'u sigurohet arsimim cilësor;
- Shkollat të afrojnë mjedis të shëndetshëm, tërheqës dhe miqësor, mësimdhënie më cilësore, në mënyrë që këto mjedise të jenë më të sigurta dhe më funksionale në misionin që kanë;
- Programet në shkollat fillore dhe të mesme në bashkëpunim me MASHTI-n, të sigurojnë përgatitjen e nxënësve që të mendojnë dhe punojnë në mënyrë kreative dhe ambicioze në zgjidhjen e të gjitha problemeve;

- Të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme dhe shprehjet e punës për t'iu përgjigjur me sukses sfidave të jetës së përditshme, shkollimit të mëtejshëm në përvetësimin e përhershëm të mësimin me moton **”Mësimi gjatë gjithë jetës”**;
- Shkollat të jenë të hapura, ku prindërit do të kenë mundësi të kyçjes në vendimet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët e tyre;
- Mësimdhënësit do të aftësohen në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e metodave të ndryshme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies.

## Objektivat strategjike

### *Objektivi strategjik 1: Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme*

Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (EFH) synon zhvillimin parësor të nevojave shoqërore, emocionale, njohëse dhe fizike të një fëmije, në mënyrë që të ndërtojë një bazë të fortë dhe të gjerë për të mësuarit dhe mirëqenien gjatë gjithë jetës, prandaj përfshirja dhe pjesëmarrja e barabartë për të gjithë fëmijët në edukimin cilësor të hershëm, nuk mund të realizohet pa krijimin e infrastrukturës adekuate. MASHTI fillimisht do të bëjë një analizë të mirëfilltë për këtë nivel të arsimit, ashtu që të planifikohet tejkalimi i sfidave me të cilat përballlet EFH, siç janë: rritja e numrit të institucioneve parashkollore (IP) dhe organizimi i shpërndarjes adekuate të tyre; zhvillimi i kornizës legjislative, kurrikulës për EFH dhe krijimi i ambientit edukativ cilësor; krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve; si dhe koordinimi ndërsektorial për ofrimin e shërbimeve cilësore në EFH

### *Objektivi strategjik 2: Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore*

Për të ngritur cilësinë në arsimin parauniversitar, është e domosdoshme të kemi një sistem i cili ofron llogaridhënie në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Për këtë qëllim duhet të kemi një menaxhim efektiv dhe efikas përmes zbatimit dhe avancimit të politikave dhe kornizës ligjore në fushën e arsimit, ngritjes së kapaciteteve dhe forcimit të transparencës dhe llogaridhënies. Për më shumë duhet fuqizuar mekanizmat për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të institucioneve arsimore me fokus në ngritjen e cilësisë, rritjen e besueshmërisë së testeve kombëtare dhe shfrytëzimin e rezultateve për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Gjithashtu, avancimi i cilësisë së arsimit parauniversitar do të arrihet përmes zbatimit efektiv të kurrikulës si dhe fuqizimit të mekanizmit funksional për ta udhëhequr dhe zbatuar atë. Për ngritjen e rezultateve të nxënësve, krahas masave tjera, do të përgatiten tekste cilësore dhe në përputhje me kurrikulën si dhe do të sigurohen mjete, materiale dhe burime mësimore alternative.

### ***Nënobjektivi Strategjik 2.1 : Zhvillimi profesional i mësimdhënësve***

Një nga prioritetet e komunës së Ferizajt është përfshirja e të gjithë mësimdhënësve në trajnime cilësore që ndihmojnë mësimdhënësit që të jenë më kreativë në mësimdhënie dhe në ofrimin e përkrahjes së nevojshme për nxënës në zotërimin e kompetencave kryesore. Fokusi do të jetë në përcaktimin e qartë të rolit të DA në ZHPM, në zhvillimin e mekanizmave për identifikim të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim të vazhdueshëm profesional, financim dhe monitorim të ZHPM, si dhe në përkrahjen e shkollave për ZHPM me bazë në shkollë. Objektivi dhe masat për ZHPM në komunën e Ferizajt janë në harmoni edhe me masat e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë.

### ***Objektivi strategjik 3: Harmonizimi i arsimit dhe aftësisë profesionale me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimin gjatë gjithë jetës***

Cilësia e pamjaftueshme e ofertës së arsimit dhe aftësisë profesionale ka rezultuar me shkallë të ulët të kënaqshmërisë së punëdhënësve me shkathtësitë/kompetencat e arritura nga kandidatët e diplomuar në IAAP, si dhe me shkallë të ulët të tranzicionit nga shkolla në punë. Mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës dhe mobilitetet janë të kufizuara dhe nuk janë në hap me nevojën për riaftësim të vazhdueshëm të fuqisë punëtore. Rrjedhimisht, përqendrimi kryesor në kuadër të kësaj fushe strategjike është rishikimi i ofertës së arsimit dhe aftësisë profesionale si dhe përmirësimi i cilësisë, në funksion të zhvillimit të shkathtësive të transferueshme, shkathtësive digjitale, shkathtësive të ndërmarrësisë dhe shkathtësive teknike profesionale,

### ***Nënobjektivi Strategjik 3.1: Arsimi dhe aftësimi profesional***

Ndërlidhja e arsimit dhe aftësisë profesionale me kërkesat e tregut të punës kërkon kohë dhe nuk mund të arrihet pa bashkëpunim me institucionet e AAP dhe bizneset. Fokusi do të jetë në funksionalizimin e Këshillit lokal për AAP, zhvillim të vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve të AAP dhe instruktorëve, zhvillim të materialeve mësimore, këshillim dhe orientim në karrierë, bashkëpunim me bizneset, pajisjen me mjete të nevojshme të punëtorëve të shkollave profesionale për të mundësuar zbatimin e kurrikulave të AAP dhe për mësimin praktik me bazë në shkollë. Masat për zhvillimin e AAP në Ferizaj janë në harmoni edhe me masat e **PSAK-ut 2022-2026**.

### ***Objektivi strategjik 5: Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital***

Me qëllim që Kosova të lëvizë sa më shpejt në drejtim të digjitalizimit të të dhënave, ofrimit të shërbimeve digjitale dhe automatizimit të proceseve në fushën e arsimit, si dhe me qëllim të rritjes së përdorimit të teknologjisë digjitale për nevoja arsimore e në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim, Kosova gjatë pesë viteve të ardhshme do të punojë në pesë drejtime: (i) krijimin dhe funksionalizimin e një platforme digjitale gjithëpërfshirëse e të centralizuar për fushën e arsimit;

(ii) përgatitjen dhe prodhimin e materialeve mësimore digjitale shumëdimensionale e cilësore për nivele, klasë, lëndë e lloje të ndryshme; (iii) furnizimin e IEAA-ve dhe IAL-ve me rrjete të internetit cilësor dhe me pajisje teknologjike të nevojshme; (iv) kultivimin e kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit të të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve; dhe (v) krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit.

#### ***Nënobjektivi Strategjik 5.1: TIK dhe mjetet e konkretizimit – digjitalizimi i shkollave***

Përdorimi i TIK-ut ndërlidhet me pajisjen e shkollave me kompjuterë, qasja në internet, shfrytëzimin e burimeve online, sigurimin e mbështetjes teknike dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe përgatitjen e mësimeve për shfrytëzimin e TIK. Këto aspekte adresohen në masat e vendosura për arritjen e këtij objektivi strategjik. Objektivi ndërlidhet me objektivin për zbatim të kurrikulës së re, Strategjia për Arsim 2022-2026 dhe me prioritetet e komunës së Ferizajt për të siguruar përdorim të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënës.

#### ***Objektivi Strategjik 4: Zbatimi i kurrikulës së re***

Me kurrikulën e re, roli i shkollës është sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillim të kompetencave. Përbushja e këtij roli të veçantë, përveç trajnimit të mësimeve, lidhet edhe me ngritjen e kapaciteteve në udhëheqje të procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, organizimin e punës së aktivave profesionale në shkolla, sigurimin e mjeteve e materialeve mësimore, si dhe përkrahjen nga DKA.

#### ***Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë***

Sigurimi i cilësisë në shkollë lidhet me vendosjen e mekanizmave efektivë për sigurim të cilësisë, funksionimin e aktiveve profesionale, koordinimin e aktiviteteve që lidhen me cilësinë, mbështetjen nga komuna, vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe planifikimin zhvillimor, monitorimin e mësimeve dhe vlerësimin e performancës së tyre. Objektivi dhe masat për sigurimin e cilësisë së arsimit në shkollat e komunës së Ferizajt janë në harmoni edhe me masat e **PSAK-ut 2022-2026**.

#### ***Objektivi Strategjik 6: Infrastruktura fizike***

Hapësirat e mjaftueshme shkollore dhe funksionale, bëjnë që nxënësit dhe personeli arsimor të ndërveprojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Për të arritur këtë, komuna e Mitrovicës është përcaktuar në arritjen e këtij objektivi duke vendosur masa dhe aktivitete, që në fokus kanë përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës, sigurinë në shkollë, menaxhimin dhe mirëmbajtjen adekuate të hapësirave e objekteve shkollore, etj.

## Orientimi i përgjithshëm

### *Rezultatet e pritshme*

- Sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe ambient tërheqës shkollor;
- Sigurimi i arsimit cilësor;
- Gjithpërfshirja në sistemin edukativo-arsimor;
- Arritja e rezultateve të përhershme në shkollimin parafillor, fillor dhe të mesëm në përputhje me reformat në arsim që janë duke u bërë në mënyrë permanente nga MASHTI;
- Zbatimi i dixhitalizimit të sistemit edukativo-arsimor;
- Bashkëpunimi dhe inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit dhe arsimit të përgjithshëm;
- Respektimi i ligjshmërisë në sferën e arsimit;
- Profesionalizimi i mëtutjeshëm i sektorëve të DA-së në pajtim me ligjin dhe udhëzimet administrative të MASHTI-t;
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve në zbatimin e kurikulës së re.
- Informimi i nevojshëm i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo arsimor në tërësi në komunën tonë.
- Bashkëpunimi me Këshillin e Prindërve Komunal, Policinë e Kosovës dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare.
- Funkcionalizimi i shkollës së kulturës fizike;
- Ristrukturimi i drejtimeve dhe profileve në shkollat profesionale.

### *Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm*

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit është që të shtohet cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie, të përmirësohet plani dhe programi si dhe të shtohet efikasiteti i punës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Ferizajt.

Gjatë vitit 2025 janë planifikuar vizita monitoruese në të gjitha institucionet shkollore, të jemi në kontakt të vazhdueshëm me organet drejtuese të shkollës, mësimdhënësit, nxënësit, shërbimin teknik dhe prindërit me qëllim të ofrimit të ndihmës për ngritje të efikasitetit dhe cilësisë së punës edukativo - arsimore dhe rritjes së të gjitha potencialeve për përparim të vazhdueshëm.

Pra, nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme, anketimeve, pyetësorëve, bashkëbisedimeve dhe instrumenteve tjera matëse do të realizohet mbikëqyrja për së afërmi e rrjedhës së punës në shkolla. Në këtë drejtim për ta përmbushur këtë qëllim, DA-ja do të bashkëpunojë ngushtë edhe me sektorin e Inspeksionit Arsimor (SIA).

Drejtoria duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit të DA-së në bazë të udhëzimit administrativ të MASHTI-t, punën e vet kryesisht do ta orientojë në:

- Krijimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të procesit edukativo-arsimor në institucionet shkollore në katër nivele;

**Niveli 0:** Arsimit parashkollor, mosha e fëmijëve prej (1-5 vjet).

**Niveli 1:** Arsimit fillor, prej moshës 6 vjet.



**Niveli 2:** Arsimi i mesëm i ulët, prej moshës 12 vjet dhe

**Niveli 3:** Arsimi i mesëm i lartë, prej moshës 15 vjet.

- Mbikëqyrjen e realizimit të planprogrameve vjetore mësimore dhe atyre konkrete të mësimdhënësve në institucionet edukativo-arsimore në të tri nivelet;
- Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollave;
- Përcjelljen dhe krijimin e kushteve të favorshme për punë të nxënësve me nevoja të veçanta;
- Mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shtesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre;
- Krijimin e kushteve të punës për stafin profesional të DA-së, duke bërë aftësimin profesional të tyre përkrah zhvillimit të shoqërisë sonë dhe trendeve bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Zyrtarët komunal arsimor vazhdimisht do të monitorojnë dhe kontrollojnë punën në shkolla, do të hartojnë edhe raporte për funksionimin e institucioneve arsimore me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe shtimin e përgjegjësisë së të gjithëve në punë;
- Organizimi i kurseve të vazhdueshme në **Qendrën për Ngritje Profesionale (QNP)** për zhvillimin profesional të mësimdhënësve me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të mësimdhënësve për punë efektive në klasë dhe për qasje bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

**Plani i punës së aktiviteteve në Drejtorinë Komunale të Arsimit  
Viti shkollor 2024-2025**

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgaditjet për fillimin e vitit të ri shkollor													DA
Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit shkollor 2024-2025 në fund të Gjysëvjetorit të parë si dhe në fundin e vitit shkollor (raport në Kuvend)													DA
Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor. Vizitë me kryetarin e Komunës në shkolla me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtarëve													DA, Kuvendi Komunal
Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillor, klasa e parë dhe klasa 10													DA & Shkolla
Java e gjelbërimit për shkollat e komunës													DA, Komuna & Shkollat
Vazhdimi i bashkëpunimit me lidhjet e krijuara me Drejtorinë Komunale dhe shkolla të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin e Ferizajt													DA & Shkollat
Organizimi dhe bartja e nxënësve për garat në lëndë të ndryshme													DA & Shkollat
Organizimi i garave në nivel komune me nxënës të shkollave fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të larta në dramë, recitim, muzikë, art, shkenca, etj.													DA & Shkollat
Bashkëpunimi me MASHTI-n, dhe Inspektoratin e Arsimit.													DA
Përgatitja e projekteve për rregullim të infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelbërta të shkollave.													DA
Organizimi i garave shkollore në sport si në: futboll të vogël, basketboll, volejball, atletikë, shah, ping pong etj.													DA
Kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHTI me qëllim publikimi i konkursit për regjistrim të nxënësve në SHML (Shkollat e Mesme të Larta)													DA, MASHTI
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme të larta													DA
Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme													DA-MASHTI
Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës me mësimdhënës të kualifikuar													DA

Formimi i komisionit për përgatitjen e testit vlerësues dhe respektimit të procedurave për përzgjedhjen e personelit arsimor													KA
Organizimi dhe mbajtja e intervistës me kandidatët konkurrues (mësimdhënës, stafi tjetër)													DA
Organizimi dhe mbajtja e intervistës me kandidatët konkurrues (drejtor, zëvendësdrejtor)													
Vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA													DA
Përgatitja e vendimeve për shkuarje në pushim vjetor të punëtorëve arsimor													DA
Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme nga konkursi plotësues													DKA
Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditar pune, libra të amzave, libra të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor													Shkollat & DA
Furnizimi i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta me tekste mësimore													Shkollat & DA
Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve njëditore të semimaturantëve dhe maturantëve													DA
Raporti 6 mujor i Drejtorisë për Arsim.													DA
Plani i punës për vitin 2025 i Drejtorisë për Arsim.													DA

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgatitja teknike e lokaleve shkollore: gëlqerosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri.													Shkollat & DA
Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse: dru, thëngjill, briket, pelet, naftë.													DA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse: dru, thëngjill, briket, pelet, naftë.													DA
Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla													DA & Shkollat
Riparimi i nyjeve të ujësjellësve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm													DA
Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktike në salla të kabineteve për lëndët: matematikë, fizikë, kimi, biologji, Si dhe banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore													DA & Shkollat
Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore													DA & Shkollat
Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive													DA & Shkollat
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste													MASHTI & DA
Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit	I përhershëm, sipas nevojës												DA & Shkollat
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave												DA & Shkollat
Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorët	Sipas kërkesave												DA & Shkollat
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave	Sipas kërkesave												DA & Shkollat
Implementimi i pjesës që ka të bëjë me Planin Zhvillimor të DA-së	Në vazhdimësi												DA, K.Komunal

**Plani i punës së procesit edukativo-arsimor gjatë viti shkollor 2024-2025**

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Rregullimi i dokumentacionit për pronat e shkollave sipas sipërfaqes kadastrale	E vazhdueshme												DA
Monitorimi i sistemit SMIA nga DA-ja													DA
Organizimi i mësimi shtesë për maturantët													DA, Shkollat
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërta shkollore													DA
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas Prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të Komunës së Ferizajt													DA, MASHT, KEK, AUK, USAID,...
Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë permanente													DA
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkoll (detyrë e përhershme), kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës, etj													DA
Analiza e punës edukativo-arsimore													DA
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës												DA
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave.	Sipas nevojës												DA
Plotësimi i vendeve të lira të punës	Sipas nevojës												DA
Vlerësimi i punës edukativo arsimore të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër													DA & Shkollat
Përgatitja profesionale e mësimdhënësve, organizimi i trajnimeve në koordinim me MASHTI-n, dhe organizatat të tjera													DA & Shkollat
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DA-së jashtë vendit													DA
Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkolla	E vazhdueshme												DA & Shkollat
Shpallja e konkurseve për personelin udhëheqës - drejtor të shkollave	Sipas nevojës												DA
Përcjellja e realizimit të mbrëmjeve të maturës													DA & Shkollat
Mbarimi i mësimi për maturantët	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI-i												MASHTI, DA
Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore	Sipas kalendarit												Shkollat
Provimi i maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI												MASHTI, DA

Publikimi i rezultateve të provimit të maturës	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Testi i arritshmërisë për klasat e IX-ta	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Paraqitja e provimit për afatin e gushtit	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	DA
Provimi i maturës - afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Publikimi i rezultateve të provimit të maturës, afati i dytë	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Shqyrtimi i ankesave të nxënësve	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA
Publikimi i rezultateve të ankesave	Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI	MASHTI, DA

***Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DA-së me Kryetarin e Komunës, MASHTI-n, Drejtoritë Komunale dhe qytetarët***

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT											Implementues	
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor		Dhjetor
Takimet dhe konsultimet me Kryetarin e Kuvendit Komunal	Të përhershme, sipas nevojës											DA	
Takimet e rregullta me MASHTI-n në kuadër të takimeve me drejtorët e DA	Të përhershme, sipas nevojës											DA, MASHTI	
Furnizimi me ligjet, udhëzimet administrative, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASHTI-n	Sipas nevojës											DA, MASHTI	
Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DA-së në MASHTI	Sipas nevojës											DA, MASHTI	
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të DA-ve të Kosovës.													DA
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore, të mesme dhe institucionit parashkollor													DA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre													DA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	I përhershëm, sipas nevojës											DA	
Bashkëpunimi i rregullt me Zyrën e Inspeksionit të arsimit në nivel regjional	Sipas nevojës											DA	
Puna me palët, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	E përditshme, sipas nevojës											DA	
Bashkëpunimi me Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuar	Sipas mundësive dhe nevojës											DA	

***Bashkëpunimi i DA-së me organet e sigurisë: Policinë, KFOR-in, OJQ-të dhe mediat***

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore organizuar nga OJQ-të	Sipas organizimit dhe ftesës												DA
Bashkëpunimi me shërbimin Policor të Kosovës	Sipas nevojës												DA
Bashkëpunimi me FSK-në	Sipas nevojës												DA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas kërkesave												DA
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas kërkesave												DA
Bashkëpunimi me donatorë vendor e të huaj	Sipas nevojës												DA

***Bashkëpunimi me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane***

Aktivitetet	KOHA E REALIZIMIT												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përmirësimi i infrastrukturës, transportit të nxënësve dhe sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DA
Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimdhënësve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike	Në vazhdimësi												DA
Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim, aneks ndërtim dhe renovim si dhe hartimi i listës prioritare	Në vazhdimësi												DA
Përmirësimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punimeve gjatë renovimeve	Në vazhdimësi												DA
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje si dhe përcaktimi i prioriteteve të shkollave me nevoja më të theksuara.	Në vazhdimësi												DA

## Buxheti i arsimit për vitin 2025 sipas kategorive

Kodi i Programit	Përshkrimi	Stafi	Paga dhe Mëditje	Mallëra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencionet	Investime Kapitale	Totali €
<b>920</b>	Arsim dhe Shkencë	<b>1797</b>	14,616,583.00	1,000,000.00	127,201.00	500,000.00	843,582.00	<b>17,587,366.00</b>
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		14,616,583.00	918,426.00	127,201.00	500,000.00	843,582.00	<b>17,587,366.00</b>
	Granti Specifik për Arsim		0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Të Hyrat Vetanake		0	200,000.00	0	136,464.00	0	<b>136,464.00</b>
<b>92160</b>	Administrata e Arsimit	<b>8</b>	63,802.00	620,000.00	0	500,000.00	0	<b>1,183,802.00</b>
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		63,802.00	470,000.00	0	500,000.00	0	<b>1,033,802.00</b>
	Granti Specifik për arsim		0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Të Hyrat Vetanake		0	0	0	150,000.00	0	<b>150,000.00</b>
<b>92830</b>	Arsimi Parashkollor	<b>46</b>	319,491.00	130,000.00	10,000.00	0	0	<b>459,491.00</b>
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		319,491.00	80,000.00	10,000.00	0	0	<b>409,491.00</b>
	Granti Specifik për Arsim		0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Të Hyrat Vetanake		0	50,000.00	0	0	0	<b>50,000.00</b>
<b>93930</b>	Arsimi Fillor, i Mesëm i Ulët	<b>1309</b>	10,349,083.00	550,000.00	80,000.00	0	683,582.00	<b>11,662,665.00</b>
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		10,349,083.00	550,000.00	80,000.00	0	683,582.00	<b>11,662,665.00</b>
	Granti Specifik për Arsim		0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Të Hyrat Vetanake		0	0	0	32,210.00	0	<b>32,210.00</b>
<b>95130</b>	Arsimi i Mesëm i Lartë	<b>434</b>	3,884,207.00	200,000.00	37,201.00	0	160,000.00	<b>4,281,408.00</b>
	Granti i Përgjithshëm për Arsim		3,884,207.00	200,000.00	37,201.00	0	160,000.00	<b>4,281,408.00</b>
	Granti Specifik për Arsim		0	0	0	0	0	<b>0</b>
	Të Hyrat Vetanake		0	0	0	0	0	<b>0</b>

Buxheti në total për vitin 2025 është **17,013,005.00 €**, që krahasuar me vitin paraprak (**16,065,900.00 €**) është më i lartë për **947,105.00 €**



*Projektet e planifikuara për vitin 2025-2027*

<b>Nr</b>	<b>Arsim dhe shkencë</b>	<b>Shuma €</b>
1	Vazhdimi i punimeve në ndërtimin i shkollës së mesme profesionale në Ferizaj	/
3	Vazhdimi i punimeve në ndërtimin i shkollës në Neredime	/
5	Vazhdimi i punimeve në ndërtimin i shkollës në fshatin në fshatin Tërrn	/
6	Ndërtimi çerdhës për fëmijë në Ferizaj	/
9	Ndërtimi çerdhës për fëmijë në Dardani	/
11	Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve shkollore	/
13	Ndërtimi i anekseve dhe renovimi i shkollave dhe sallave sportive	/
14	Rregullimi dhe mirëmbajtja e oborreve të shkollave	/
<b>Gjithsej</b>		/

## Plani i Rekrutimit të Personelit Arsimor – viti kalendarik 2025

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara rekrutimet sipas niveleve shkollore dhe llojeve të personelit të paraqitura sipas muajve për vitin **2025**. Këto rekrutime janë të domosdoshme ngase janë pensionime.

M u a j i	Numri i rekrutimeve	Lloji i personelit									
		Drejtor shkolle	Z.drejtor	Sekretar	Pedagog	Mësimdhënës	Psikolog	Edukatore	Bibliotekist	Punëtor teknik	Detyrë tjetër
Janar	Sipas kërkesës					2				1	
Shkurt						5					
Mars						4				2	
Prill			1			3		1		3	
Maj				1		2					
Qershor			2	1		3		2		2	
Korrik						4				1	
Gusht						1					
Shtator						1					
Tetor						6					
Nëntor						2					
Dhjetor			1	1		3		1			
<b>Totali</b>		<b>3</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>/</b>	<b>36</b>	<b>/</b>	<b>4</b>	<b>/</b>	<b>9</b>	<b>/</b>
<b>Gjithsej</b>		<b>56</b>									

Ferizaj 2025

Drejtori i Arsimit  
Afrim Llabjani